



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 44, datë 01/10/2004

**“MBI
KALIMIN KAPITAL TË DISA PAJISJEVE KOMPJUTERIKE DHE
NDËRLIDHËSE NJËSIVE BASHKIAKE NR.3, 4, DHE 7, TIRANË”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të datës 1/10/2004, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Financës, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.153, dt.03/04/1993 “Për kalimin kapital të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, pika 2, gërma ç, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I;

1. Të bëhet kalimi kapital, nga Bashkia e Tiranës në Njësitë Bashkiake Nr.3, 4, dhe 7 i pajisjeve kompjuterike dhe ndërlidhëse sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Financës dhe Njësitë Bashkiake Nr.3, 4 dhe 7 Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI